



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIQUE DU KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO			
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR			
Njësia Org.	5	Nr. Prot:	1507
Org. Jedinica		Broj Prot:	
Org Unit		Prot. No:	
Nr. i faqeve	2	Data:	25.09.2024
Br. stranic		Datum:	
No. pages			

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Nr. 5/1507
Dt. 25-09-2024

Komisioni për licencimin dhe rilicencim të BPrAL në Ministrin e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe nenit 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037, në bazë të neneve 5, 6, 7 dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë dhe Udhëzimit administrativ nr. 17/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (MASHT) 25/2012 për licencimin e bartësve privat të arsimit të lartë në Kosovë, kërkesave nr. 1507 të datës 17.05.2024 dhe nr. 2530 datë 27.08.2024 të parashtruar nga BPrAL- kolegji “Biznesi” nxjerr:

V E N D I M
Për rilicencimin e kolegjit “Biznesi”

1. Bartësi Privat të Arsimit të Lartë /kolegji “Biznesi” qendra në Prishtinë, rilicencohet në nivel institucional për periudhën (3) vjeçare (1 tetor 2024 deri me 30 shtator 2027) sipas vendimit të AKA-s nr. 875/24, datë 10.05.2024.
2. Licencohen programet e studimit Menaxhment dhe Ekonomiks BA 180 ECTS, Menaxhment dhe Financa MA 120 ECTS dhe Menaxhimi i Emergjencave MA 120 ECTS, për periudhën tre (3) vjeçare (1 tetor 2024 - 30 shtator 2027) sipas vendimit nr. 1515/24 datë: 05.08.2024, dhe vendimit nr. 1707/24 datë: 20.08.2024 të Agjencionit të Kosovës për Akreditim.
3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesave nr. 1507 të datës 17.05.2024 dhe nr. 2530 datë 27.08.2024 - ndërrim lokacioni vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për licencim.

Licenca e këtij institucioni privat të arsimit të lartë zgjat tri vite akademike, si në atë institucional dhe të programeve të studimit bazuar në vendimet e Agjencionit të Kosovës për Akreditim, pra për periudhën kohore nga data 1 tetor 2024 deri me 30 shtator 2027, si në dispozitiv të pika 1 dhe 2.

Sipas kërkesës së BPrAL nr. 2530 datë: 27.08.2024 për ndërrim lokacioni, parashtruar Komisionit për licencimin dhe rilicencim të BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, komisioni ka vizituar lokacionin dhe ka konstatuar përkundër disa mangësive se ky institucion i ka plotësuar kushtet dhe kriteret teknike dhe ligjore me kërkesë të vetme që brenda këtij viti mësimor (gjer në shtator 2025) të siguroj pëlqimin për ndryshim të destinimit të objektit, nga organet kompetente të komunës së Prishtinës.

Komisioni për Licencim dhe Rilicencim në MASHTI, duke marrë parasysh faktet e ofruara nga ky institucion si dhe dokumentacionin e kompletuar për aplikim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi në Komisionin për ankesa të nëpunësve publik dhe ankesave të tjera në MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Kolegjit "Biznesi";
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. DALSHT;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. DNJBIA
7. Arkivit.


Kryetar i Komisionit

Burim Gashi